



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 50 Prot.

Vlorë më, 25.07.2018

**V E N D I M**

Nr. 09 , datë 25 .07.2018

**"PËR ULJEN E KOSTOVE DHE VLERËSIMIN E NEVOJAVE PËR NDRYSHIME  
STRUKTURE NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"**

*Bazuar në nenin 47 dhe germën "dh" të pikës 1 të nenit 49 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenit 29, germës "a" ,"c","d", të pikës 2 të tij, nenit 52 pika "b" ,të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit;*

Bordi i Administrimit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" (në vijim KUPV), mbi propozimin datë 24.07.2018 të Administratorit të KUPV;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë propozimin datë 24.07.2018 e Administratorit të KUPV për marrjen e masave për uljen e kostove dhe vlerësimin e nevojave për ndryshime strukturore të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë".
2. Të pezullojë të gjitha kontratat e punës së stafit akademik.
3. Kontratat do të rilidhen në shtator (dhjetëditëshi i parë i shtatorit), për të gjithë ata pjestarë të stafit që do të konfirmohen në detyrë.
4. Anëtarët e stafit akademik për të cilët do të rilidhet kontrata e punës ,do të njoftohen paraprakisht nga ana e drejtuesit të Institucionit, pas të cilit do të vijojë paraqitja e tyre pranë tij.
5. Për anëtarët e stafit akademik për të cilët do të rilidhet marrdhënia e punësimit ,do të ketë një proces rinegociimi të të gjitha kushteve të kontratës, me vlerësim të formularit të Folloë - up, arritjeve dhe gjithë pritshmërive.
6. Periudha e shtatorit e vitit akademik të sipërshënuar do të përfshijë procesin e rekrutimeve,

7. Rektori ,Administratori dhe Zyra e Burimeve Njerëzore duhet të marrin masat e duhura administrative për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari i Bordit të Administrimit**

**PhD Siri Hoxha**

